




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK	Nr. fol. 01-828/14
Dep. 02	01-11-03-2014



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	10.03.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Isa OSMANKAJ UD. Menaxher i Sektorit për Prokurim në Komunën e Prizrenit
CC:	z. Ramadan MUJA Kryetar i Komunës së Prizrenit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Furnizimi me komposterë për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Prizrenit "

I nderuari z. Osmankaj,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Furnizimi me komposterë për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Prizrenit", me nr. të prokurimit: 622-14-011-121, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Furnizimi me komposterë për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Prizrenit" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Komuna e Prizrenit, përmes Sektorit për Prokurim ka përgatitë “Njoftimin për Kontratë” me titull “Furnizimi me komposterë për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Prizrenit” me nr. prokurimi:622-14-011-121,e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 18.02.2014, në Procedurë të Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, pranë Agjencisë kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të kësaj procedure të prokurimit në “Njoftimin për Kontratë” Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me Procedurat e Prokurimit të cilat rregullohen me Ligjin e Prokurimit Publik i cili është në fuqi në Republikën e Kosovës.

Agjencia kundër Korrupsionit, konstaton qartë se Autoriteti Kontraktues Komuna e Prizrenit, këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka paraparë tek pozicioni i Kontratave për furnizim në Planifikimin e Prokurimit për vitin 2014.

Në “Njoftimin për Kontratë” i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, më datë 18.02.2014, tek rubrika “Kushtet teknike-operative”, pika.2 kërkohet që **Operatori ekonomik që do të jetë fitues i tenderit duhet ta ketë pikën e shitjes në Qytetin e Prizrenit**, pikë kjo për të cilën konsiderojmë se është në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik .

Autoriteti Kontraktues Komuna e Prizrenit me formulimin e kësaj kërkesë tek rubrika “Kushtet teknike-operative” të “Njoftimit për Kontratë”, ka bërë Diskriminim territorial në kundërshtim me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik ku thuhet se “Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik “, duke kërkuar që Operatori Ekonomik që do të jetë fitues i tenderit ta ketë pikën e shitjes në Qytetin e Prizrenit, favorizohen OE që kanë pika te shitjes në Prizren dhe në të njëjtën kohë, u pamundësohet OE që nuk kanë pika të shitjes në Prizren të ofertojnë për këtë tender.

Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatorët ekonomik të cilët ofrojnë furnizimet përkatëse. Pra, të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe nenin 8 Planifikimi i Prokurimit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !